



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

V E N D I M

Nr. 4 Datë 18/01/2019

“ Për

Miratimin e lejes për përdorim uji “Për Amballazhim në shishe ose enë”, Subjektit “ZEPA-FAN” shpk, me vendodhje; Fshati Petoç-Fan, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë”.

Në mbështetje të neneve 7 pika 2 , nenit 50, 51 dhe nenit 52 të ligjit nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar me ligjin nr. 6/20018 “Për disa ndryshime dhe shtesa...”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, si dhe kërkesës së subjektit “ ZEPA-FAN ”shpk, me propozim të A.B.U. Mat; Këshilli i Basenit Ujor Mat;

V e n d o s i:

1. Miratimin e “Lejes për përdorim uji për amballazhim në shishe ose enë, burim natyror, sipas studimit të paraqitur nga subjekti “ ZEPA-FAN ” shpk, me administrator z. Tonin GJOKA, me këto të dhëna:

-Vendndodhja e burimit natyror , Fshati Petoç-Fan, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë

-Sasia e ujit për përdorim 0.007 m³/s

-Prurja mesatare : $Q_{mes} = 0.009 \text{ m}^3/\text{sek}$,

-Prurja llogarites: $Q_{llog} = 0.013 \text{ m}^3/\text{sek}$,

-Prurja ekologjike: $Q_{ekol} = 0.004 \text{ m}^3/\text{sek}$,

-Kuota e vepres së marrjes $Z = 627 \text{ m}$ X- 41 56 11.64 Y- 20 10 38.08

(Kuota e vepres së marrjes në KRRGJSH) $Z = 627 \text{ m}$ X- 51 48 20 Y-46 44 667

- Kuota e shkarkimit $Z = 606 \text{ m}$ X- 41 51 11.62 Y- 20 10 38.081

(Kuota e shkarkimit në KRRGJSH) $Z = 606 \text{ m}$ X- 51 48 06 Y-46 44 655

2.Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes,i furnizimit me ujë të popullatës etjerë nga përdorimi i ujit për amballazhim në shishe ose enë.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I Z.A.B.U. ISHEM-ERZEN-MAT
Adrian SHTINO

